



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E LARTË  
MBLEDHJA E POSAÇME E GJYQTARËVE

Nr. 1106 prot.

Tiranë, më 15.3.2022

V E N D I M

Nr. 2, datë 15/3/2022

**PËR ZGJEDHJEN E z. SANDËR BECI, ANËTAR TË GJYKATËS KUSHTETUESE**

Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë, e përbërë nga gjyqtarët:

Sokol Sadushi	Zëvendëskryetar
Illir Panda	Anëtar
Ervin Pupe	Anëtar
Medi Bici	Anëtar
Sokol Binaj	Anëtar
Albana Boksi	Anëtare
Sandër Simoni	Anëtar
Artur Kalaja	Anëtar
Asim Vokshi	Anëtar
Arbena Ahmeti	Anëtare
Gentian Medja	Anëtar

në mbledhjen e datës 15.03.2022, e cila kishte në rend të ditës zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, që është në emërtesë të saj,

**Vëren:**

1. Sipas nenit 125 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Gjykata e Lartë është një nga organet që zgjedh 3 (tre) anëtarë të Gjykatës Kushtetuese.
2. Mbi bazën e njoftimit të Gjykatës Kushtetuese për krijimin e një vendi vakant, që sipas formulës së përcaktuar në Kushtetutë është në emërtesën e Gjykatës së Lartë, kjo e fundit rishpalli thirrjen e shprehjes së interesit për plotësimin e vendit vakant në datë 03.06.2021, për shkak të mosplotësimit nga thirrjet e mëparshme.

3. Lista e kandidatëve që aplikuan së bashku me dokumentacionin shoqërues iu përcoll Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, organ që ka në kompetencë kryerjen e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore, pikëzimin dhe renditjen e kandidatëve.

4. Në përfundim të procesit të shqyrtimit të kandidaturave nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datë 31.12.2021, Gjykatës së Lartë iu përcoll lista e kandidatëve së bashku me raportin dhe dokumentacionin përkatës.

5. Gjykata e Lartë, në datë 26.01.2022, zhvilloi mbledhjen për të zgjedhur kandidatin për anëtar të Gjykatës Kushtetuese. Për shkak të mungesës së kuorumit ligjor (me të paktën 10 gjyqtarë), Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve vendosi shtyrjen e saj deri në momentin e plotësimit të trupës gjyqësore me numrin e nevojshëm të gjyqtarëve që lejon vlefshmërinë e mbledhjes.

6. Në datë 16.02.2022 dhe 07.03.2022, u emëruan dy gjyqtarë të rinj në Gjykatën e Lartë, fakt i cili bëri të mundur plotësimin e kuorumit ligjor të nevojshëm për zhvillimin e mbledhjes. Për këtë arsye, Mbledhja e Posaçme vendosi të procedojë fillimisht me miratimin e rregullave specifike për mënyrën e procedimit të mbledhjes për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

7. Me Vendimin nr. 1, datë 24.02.2022, u miratua “*Rregullorja e Mbledhjes së Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese*”, në të cilën u përcaktuan procedurat dhe modalitetet e zhvillimit të procesit të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

8. Mbi bazën e Rregullores së sipërcituar, si dhe referuar listës së kandidatëve të përcjellë nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë, me urdhrin nr. 46, datë 01.03.2022, miratoi fletën tip të votimit për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese. Fleta e votimit përmbante listën me këta kandidatë: Alket Jaupi, Sandër Beci dhe Ervin Karamuço.

9. Në datën 03.03.2022, Zëvendëskryetari njoftoi gjyqtarët e Gjykatës së Lartë për zhvillimin e mbledhjes për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese në datë 15.03.2022.

10. Në Mbledhjen e Posaçme të Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë morën pjesë të gjithë gjyqtarët e Gjykatës së Lartë (11 gjyqtarë), duke plotësuar numrin e mjaftueshëm për vlefshmërinë e mbledhjes dhe realizimin e procesit të zgjedhjes së anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

11. Në datë 11.03.2022, kandidati Ervin Karamuço paraqet kërkesën për të hequr dorë nga procesi i votimit. Në kushtet kur Zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë e kishte miratuar paraprakisht fletën e votimit (datë 01.03.2022) dhe duke qenë se dorëheqja e kandidatit Ervin Karamuço është paraqitur më pas, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë konkludoi se mbetet e pandryshuar lista me renditjen e kandidatëve të paraqitur nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi.

12. Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve zhvilloi procesin e votimit, i cili është i fshehtë. Për administrimin e procesit të votimit u krijua një komision votimi i posaçëm, i cili përbëhej nga Kancelari i Gjykatës së Lartë, Kryesekretarja dhe një sekretare gjyqësore.

13. Në përfundim të procesit të votimit, komisioni i votimit, pas numërimit të fletëve të votimit dhe votave, deklaroi numrin e votave të marra nga kandidatët, nga ku rezultoi se kandidati Sandër Beci mori 7 (shtatë) vota, ndërsa 4 (katër) vota nuk ishin për asnjë kandidat.

14. Sipas nenit 7/ç, pika 4, të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese nevojitet një shumicë prej 3/5 të gjyqtarëve të pranishëm. Në kushtet kur kandidati Sandër Beci, fitoi shumicën e votave (7 nga 11 vota) të nevojshme nga ligji, ky kandidat konsiderohet i zgjedhur në detyrën e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese.

### PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të pikës 1 të nenit 125 të Kushtetutës dhe të nenit 7/ç të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar), bazuar në rezultatet e votimit të zhvilluar në datën 15.02.2022 për zgjedhjen e anëtarit të Gjykatës Kushtetuese, Mbledhja e Posaçme e Gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë,

### V E N D O S I:

1. Z. Sandër Beci zgjidhet anëtar i Gjykatës Kushtetuese.
2. Ky vendim i dërgohet Kryetarit të Kuvendit, Presidentit të Republikës dhe Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese.
3. Ky vendim publikohet në Fletoren Zyrtare dhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë.

**Sokol SADUSHI**  
Zëvendëskryetar

**Ilir PANDA**  
Anëtar

**Ervyn PUPE**  
Anëtar

**Medi BICI**  
Anëtar

**Sokol BINAJ**  
Anëtar

**Albana BOKSI**  
Anëtare

**Sandër SIMONI**  
Anëtar

**Artur KALAJA**  
Anëtar

**Asim VOKSHI**  
Anëtar

**Arbena AHMETI**  
Anëtare

**Gentian MEDJA**  
Anëtar

